

## NJOFTIM PËR MEDIA

Sot, më datë **04.04.2024**, ora **09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Nafije Hasko (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.2 Regj.Themeltar, Datë 26.03.2024 Regjistrimi, me:

**PADITËS:**

P.B.P.P.SH.

Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptare, përfaqësuar nga Krenar Rryci.

**IPADITUR:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Erdal Mema dhe Juneta Dumi.

**OBJEKTI:**

Kërkojmë nga Kolegji Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, të detyrojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të marrë vendim për ankimin e depozituar në K.Q.Z më datë 14.06.2021, ora 10:15 min, shiko bashkangjitur me të, dy dokumenta me tre faqe, afat i shqyrtimit të këtij ankimi, sipas nenit 152 të Kodit Zgjedhor, vazhdon deri në përfundim të shqyrtimeve administrative të ankimimeve të cilat akoma nuk kanë përfunduar.

**BAZA LIGJORE:**

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, neni 145/2, neni 152.

me Vendimin Nr.2, datë 04.04.2024, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

### VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 04.04.2024.

**Tiranë, më 04.04.2024**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**